



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë **18.06.2024** Nr. Regj. Them. **375**, janë paraqitur **2** kërkesa penale nga kërkuesit **Miklovan Petro dhe Ilmi Ulku**, me të njëjtin objekt: Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit me karakter ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale, dhënë me vendimin nr. 62, datë 05.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Fier, miratuar me vendimin Nr. 24 Akti, datë 18.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shtetasin **Miklovan Petro dhe Ilmi Uku** të dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 dhe 25 të Kodit Penal.
2. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me një vendim të vetëm vendosi: Bashkimin e kërkesave penale, si një kërkesë e vetme. Në përfundim të gjykimit, Gjykata bazuar në nenin 267 të Kodit të Procedurës Penale me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin Nr. **375**, datë 20.06.2024, vendosi:
 1. Pranimin e kërkesës së kërkuesve **Miklovan Petro dhe Ilmi Uku**.
 2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Miklovan Petro**, me vendimin Nr.62-2024-1217, datë 05.03.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Fier, miratuar me vendimin nr.24, datë 18.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin

nr.19(87-2024-132) datë 16.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” parashikuar nga neni 242 i Kodit të Proçedurës Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Ilmi Uku**, me vendimin Nr.62-2024-1217, datë 05.03.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Fier, miratuar me vendimin nr.24, datë 18.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.19(87-2024-132) datë 16.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
4. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për
6. Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brënda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 20.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar